

**UDHËZIM**  
**Nr. 12, datë 2.5.2023**

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN E PËRBASHKËT NR. 1, DATË  
10.3.2020, “PËR RREGULLAT DHE MASAT PËR TRAJTIMIN E AMBALAZHEVE  
DHE PALETAVE PREJ DRURI”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; si dhe të pikës 4, të nenit 11, të ligjit nr. 105/2016, datë 14.10.2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar, ministri përgjegjës për bujqësinë dhe ministri përgjegjës për mjedisin

**UDHËZOJNË:**

Në udhëzimin e përbashkët nr. 1, datë 10.3.2020, “Për rregullat dhe masat për trajtimin e ambalazheve dhe paletave prej druri”, bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

1. Kudo në udhëzimin e përbashkët emërtimi “agjencive rajonale të shërbimit veterinar dhe mbrojtjes së bimëve (ARSHVMB)”, zëvendësohet me emërtimin “drejtoritë rajonale të veterinarisë dhe mbrojtjes së bimëve (DRVMB)”.

2. Në pikën 2, të nenit 9, pikën 3, të nenit 10, dhe shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 11, togfjalëshi “struktura përgjegjëse e mbrojtjes së bimëve (SPMB)” dhe shkurtimi “SPMB” zëvendësohen përkatësisht me “Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB)”, dhe shkurtimin “AKVMB”.

3. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen strukturat përkatëse të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, që lidhen me mbrojtjen e bimëve dhe pyjet. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**  
**Frida Krifca**

**MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT**  
**Mirela Kumbaro**